

**Banka Për Biznes, Zyra Qendrore shpall konkurs për pozitën:**

## KONKURS

### **Udhëheqës/e i/e Departamentit të Auditimit të Brendshëm**

#### **Kualifikimet:**

Udhëheqësi i departamentit të auditimit të brendshëm duhet të jetë individ me reputacion të lartë etik dhe profesional dhe me një përvojë adekuate në fushën bankare dhe të auditimit.

Udhëheqësi i Auditimit të Brendshëm do t'i raportojë:

- Komitetit të auditimit;
- Bordit të Drejtorëve, sipas nevojës.

#### **Kualifikimet e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm:**

- Kualifikim Universitar në Ekonomi;
- Së paku 5 vite përvojë pune në auditim të brendshëm/jashtëm, nga to së paku 3 vite përvojë pune në institucione financiare;
- Njërin nga kualifikimet profesionale të mëposhtme:
  - I. Association of Chartered Certified Accountants - ACCA;
  - II. Certified Internal Auditor - CIA (theIIA);
  - III. Auditor i Certifikuar në Kosovë;
  - IV. Auditor i Brendshëm i Certifikuar në Kosovë;
- Aftësi profesionale për të implementuar dhe përcjellur standardet procedurale dhe teknikat e auditimit në fushat operuese të bankës;
- Njohuri dhe përvojë lidhur me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
- Njohuri të parimeve për administrimin e rreziqeve dhe teknikave prudenciale të auditimit të brendshëm të institucionit financiar.

## **Përgjegjësitë:**

- Ekzaminimi dhe vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- Rishikimi i aplikimit dhe efektiviteti i procedurave për menaxhimin e rrezikut dhe metodologjive për vlerësimin e rrezikut;
- Rishikimi i sistemeve të menaxhmentit dhe të informacioneve financiare, përfshirë sistemin elektronik të informacioneve dhe shërbimet elektronike bankare;
- Rishikimi i saktësisë dhe besueshmërisë së regjistrave të kontabilitetit dhe të raporteve financiare;
- Rishikimi i mjeteve për ruajtjen e aseteve;
- Rishikimi i sistemit të bankës për vlerësimin e kapitalit të saj në lidhje me vlerësimin e rrezikut;
- Vlerësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të operacioneve;
- Testimi i transaksioneve dhe funksionimit të procedurave specifike të kontrollit të brendshëm;
- Rishikimi i sistemeve të themeluara për të siguruar pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullative, kodin e sjelljes dhe implementimin e politikave dhe procedurave;
- Testimi i besueshmërisë dhe përpikëshmërisë së raportimeve rregullatore;
- Vlerësimi i efikasitetit të politikave, procedurave dhe standardeve të Bankës;
- Koordinimi i kornizave të auditimit me auditorët e jashtëm;
- Përfundimi i detyrave specifike të auditimit sa i përket planifikimit, ekzekutimit, dhe raportimit të departamentit të auditimit të brendshëm, rekrutimit, trajnimit dhe motivimit të personelit të auditimit të brendshëm.

- **Procedura e aplikimit:**

Ju lutem dërgoni CV në email-in: [komitetiauditimit@bpbbank.com](mailto:komitetiauditimit@bpbbank.com)

Pas seleksionimit të dokumentacionit do të ftohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë.  
Afati i aplikimit është deri me datë: 08.11.2018